

**VENDIM**  
**Nr.169, datë 28.3.2007**

**PËR PROCEDURËN E DORËZIMIT TË AKTIT TË INSPEKTIMIT DHE ELEMENTET  
E PËRMBAJTJES SË TIJ**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 30 të ligjit nr.9634, datë 30.10.2006 “Për inspektimin e punës dhe Inspektoratin Shtetëror të Punës”, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Akti i inspektimit është dokumenti, i lënë nga inspektori i punës/grupi i inspektorëve të punës, në subjektin e kontrolluar, ku përcaktohen:

- a) shkelja e vënë re;
- b) afati ligjor dhe masat, që duhet të ndërmerren për përmirësimin e shkeljes;
- c) sanksionet ligjore, që vendosen ndaj subjektit të kontrolluar.

2. Akti i inspektimit, i cili është sipas formatit, që i bashkëlidhet këtij vendimi, mban simbolin e Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe plotësohet nga inspektori i punës/grupi i inspektorëve të punës në të gjitha rubrikat e tij. Akti i inspektimit duhet të përmbajë:

- a) adresën e saktë, ku ushtron veprimtarinë subjekti;
- b) emrin dhe mbiemrin e përfaqësuesit të subjektit;
- c) llojin e veprimtarisë;
- ç) numrin e sigurimit, shoqëror dhe shëndetësor, të punonjësve;
- d) datën e fillimit dhe të mbarimit të inspektimit;
- dh) numrin e inspektimeve, që janë kryer në këtë subjekt;
- e) shkeljet e vëna re, shoqëruar me referencën në dispozitat ligjore;
- ë) detyrat e lëna për marrjen e masave për shkeljen e vënë re, si dhe afatet kohore, për t’u përmbushur këto detyra;
- f) sanksionin ligjor, që vendoset ndaj subjektit.

3. Akti i inspektimit mbahet në 3 kopje, nga të cilat një kopje i dorëzohet subjektit, një kopje dërgohet në Drejtorinë e Përgjithshme të Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe një kopje e mban inspektori i punës/grupi i inspektorëve të punës.

4. Akti i inspektimit nënshkruhet nga inspektori i punës/grupi i inspektorëve të punës, si dhe nga përfaqësuesi i subjektit ose personi i ngarkuar prej tij, në subjektin, ku kryhet kontrolli.

5. Në rastet kur përfaqësuesi i subjektit ose personi i ngarkuar prej tij refuzon të nënshkruajë aktin e inspektimit, ky i fundit duhet të shënojë se refuzon ta nënshkruajë aktin e inspektimit, si dhe të japë arsyen, për të cilën e refuzon atë.

6. Në rastet kur inspektori i punës/grupi i inspektorëve të punës vëren shkelje të legjislacionit të punës për mosdeklarimet e punëmarrësve në zyrën e punësimit dhe në Inspektoratin Shtetëror të Punës, këtij akti duhet t’i bashkëlidhet edhe lista me emrat dhe mbiemrat e punëmarrësve të padeklaruar.

7. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Inspektorati Shtetëror i Punës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**



QARKU \_\_\_\_\_  
RRETHI \_\_\_\_\_

Nr. \_\_\_\_\_

Data e fillimit të inspektimit: \_\_\_\_\_  
Data e mbarimit të inspektimit: \_\_\_\_\_

Inspektimi numer ☐

## AKT INSPEKTIMI

Subjekti: \_\_\_\_\_

Punëdhënësi (Përfaqësuesi i tij): \_\_\_\_\_

Adresa: \_\_\_\_\_

Lloji i Aktivitetit: \_\_\_\_\_

Numri i Sigurimit Shoqëror sipas kontratës midis palëve: \_\_\_\_\_

Numri i Sigurimit Shëndetësor sipas kontratës midis palëve: \_\_\_\_\_

### **Rubrika I**

Janë realizuar: \_\_\_\_\_

Nuk janë realizuar: \_\_\_\_\_

### **Rubrika II**

Shkelje të evidentuara (referenca në dispozita ligjore): \_\_\_\_\_

### **Rubrika III**

Detyra për t'u realizuar me afate kohore respektive \_\_\_\_\_

### **Rubrika IV**

Masë ligjore marrë ndaj subjektit për: \_\_\_\_\_

*Ky akt-inspektimi mbahet në dy kopje, një për punëdhënësin, një për inspektorin përkatës.  
Bashkëngjitur këtij dokumenti do të gjeni listën (emer mbiemer) e punëmarrësve të padëklaruar  
në Zyrën e Punësimit apo në ISHP të evidentuar gjatë inspektimit.*

### **Përfaqësuesi i Subjektit**

(emer, mbiemer, firmë) \_\_\_\_\_  
Refuzon firmën për: \_\_\_\_\_

### **INSPEKTORI I PUNES**

(emer, mbiemer, firmë) \_\_\_\_\_

